

RELACION

PËR

AKTIN NORMATIV “PËR DHURIMIN E APARTAMENTEVE FAMILJARËVE TË VIKTIMAVE, SI PASOJË E TËRMETIT TË DATËS 26.11.2019”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Në kuadër të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës Tiranë dhe Lezhë me vendimin nr.750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, i ndryshuar, si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, familjeve të viktimave do t’u vihet në ndihmë nëpërmjet dhurimit të 17 apartamenteve në pronësi të Bashkisë Tiranë, të ndodhura në njësinë administrative nr.1, Tiranë, dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore do të dhurojnë në favor të familjarëve të viktimave edhe apartamente nga fondi publik i banesave sociale, të përfituara sipas legjislacionit për strehimin social.

Akti normativ propozohet për shkak të nevojës që lind për përballimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, duke i ardhur në ndihmë familjarëve të viktimave të cilët humbën jetën gjatë tërmetit të datës 26.11.2019, dhe kanë pësuar dëmtime në banesat e tyre duke i bërë ato të pabanueshme.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky akt normativ është parashikuar në kuadër të masave ligjore të ndërmarra nga qeveria për të shmangur pasojat e ardhura nga tërmeti për familjarët e viktimave të cilët humbën jetën gjatë tërmetit të datës 26.11.2019, të cilët kanë pësuar dëmtime në banesat e tyre.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij akti normativ është diktuar në kuadër të masave që po merr qeveria për t’u ardhur në ndihmë familjarëve të viktimave të cilët humbën jetën gjatë tërmetit të datës 26.11.2019 dhe banesat e tyre pësuan dëmtime të cilat e bëjnë të pamundur vijimësinë e jetës në këto kushte.

Ky akt normativ synon të minimizojë pasojat e tërmetit duke i siguruar familjarëve të viktimave banesa të cilat do të dhurohen nga njësitë e

vetëqeverisjes vendore. Kështu Bashkia Tiranë do të dhurojë 17 apartamente familjarëve të viktimave, apartamente të cilat janë në pronësi të kësaj bashkie.

Për të krijuar mundësinë e një strehimi sa më të shpejtë në kushtet e situatës emergjente të krijuar nga tërmeti i datës 26.11.2019, në këtë akt normativ është parashikuar përjashtimi nga parashikimi i ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën”, dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës kryen fillimisht regjistrimin e apartamenteve që do të dhurohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme në emër të Bashkisë Tiranë dhe më pas kryen veprimet e nevojshme për kalimin e regjistrimin e tyre në pronësi të familjarëve të viktimave të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019.

Procedura e dhurimit të këtyre apartamenteve do të realizohet nëpërmjet kontratës së dhurimit, sipas parashikimeve të Kodit Civil, si dhe duke ndjekur procedurat përkatëse në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ku këshilli bashkiak do të japë pëlqimin për dhurimin e pronave të bashkive sipas këtij akti normativ.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti i propozuar për miratim është akt normativ me fuqinë e ligjit në bazë të nenit 101 të Kushtetutës, i cili përcakton se Këshilli i Ministrave në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit. Ky akt normativ është në harmoni me ligjin nr.22/2018, “Për strehimin social”, dhe me ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk synon përafrim me *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Akti normativ “Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019” përbëhet nga 6 (gjashtë) nene.

Në nenin 1 parashikohet dhurimi i 17 apartamenteve në pronësi të Bashkisë Tiranë, të ndodhura në njësinë administrative nr.1, Tiranë, për familjarët e viktimave të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019. Gjithashtu, njësitë e qeverisjes vendore dhurojnë në favor të familjarëve të viktimave të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 edhe apartamente nga fondi publik i banesave sociale, të përfituara sipas ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”.

Në nenin 2 parashikohet se Këshilli Bashkiak jep pëlqimin për tjetërsimin e këtyre pasurive të paluajtshme në favor të familjarëve të viktimave të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, sipas parashikimeve të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar. Apartamentet që dhurohen për familjarët e viktimave të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, hiqen nga lista e pasurive të paluajtshme të bashkive përkatëse.

Neni 3 parashikon se pavarësisht parashikimeve të ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, dhe vendimit nr.408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, Bashkia Tiranë, brenda 2 (dy) ditëve pune lëshon certifikatën e përdorimit sipas gjendjes dhe dokumentacionit ekzistues të objektit.

Kontrata e dhurimit do të realizohet sipas parashikimeve të Kodit Civil dhe do të nënshkruhet nga kryetarët e bashkive në të cilat është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore dhe përfaqësuesit e familjeve përfituese të përcaktuara në listën e dërguar nga Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile. Shpenzimet procedurale për kryerjen e transaksioneve për dhurimin e pasurisë paguhet nga bashkitë në të cilat është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore.

Apartamenti i dhuruar do të regjistrohet në bashkëpronësi të të gjithë anëtarëve të familjes përfituese.

Në nenin 4 është parashikuar se strukturat shtetërore të vendosin në dispozicion të gjitha burimet njerëzore dhe mjetet logjistike të nevojshme që nevojiten për transferimin e këtyre familjeve në banesat e reja në Tiranë. Të gjitha shpenzimet e mobilimit dhe të pajisjeve elektroshtëpiake për këto apartamente mbulohen nga buxheti i shtetit.

Në nenin 5 parashikohet se ngarkohen kryetari i Bashkisë Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe kryetarët e njësive të vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore për zbatimin e këtij akti normativ.

Neni 6 parashikon se ky akt normative hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet që ngarkohen me zbatimin e këtij akti normativ janë kryetari i Bashkisë Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe kryetarët e njësive të vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Akti normativ është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Brendshme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare të këtij akti normativ për dhurimin e apartamenteve dhe çdo shpenzim procedural për kryerjen e transaksioneve për dhurimin e tyre do të përballohen nga buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore.

Të gjitha shpenzimet për burimet njerëzore dhe mjetet logjistike të nevojshme që nevojiten për transferimin e këtyre familjeve në banesat e reja në Tiranë, si dhe shpenzimet e mobilimit të pajisjeve elektroshtëpiake për këto apartamente mbulohen nga buxheti i shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE